

10.02.2022  
Ora 17:07

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.


**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- Ilirjan            CELIBASHI            Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana            NANO                      Kryetar
- Arens              ÇELA                      Anëtar
- Dritan              ÇAKA                      Anëtar
- Helga               VUKAJ                     Anëtar
- Muharrem        ÇAKAJ                     Anëtar
- Stafi                KQZ                        Y.Merkaj, M.Koja
- Parti                Politike:                   PD (M.Logu), LSI (A.Kaziaj)

*Znj. I. Nano:* Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, datë 10 shkurt 2022. Njoftimi për mbledhjen është publikuar në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. U është njoftuar dhe subjekteve zgjedhore të regjistruara në KQZ, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Në mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator. përfaqësues të subjekteve zgjedhore, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi

Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.10.02.2022*


shqyrtimin e një projektvendimi “Për procedurën e hedhjes së shortit për miratimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

Më lejoni të pyes kolegët dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar?

Kolegë, zoti Logu, zoti Kaziaj? Faleminderit! Nuk kemi çështje jashtë rendit të ditës për diskutim. Kështu që fillojmë me çështjen që kemi në rendin e ditës. Ky projektvendim ka ardhur me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Do t’i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm të prezantonte projektaktin!

**Z. Y. Merkaç:** Presidenti i Republikës ka dekretuar datën 6 Mars 2022 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Në referim të neneve 20, pika 1, shkronja “a”, 98 pika 5 e Kodit Zgjedhor po i propozojmë Komisionit Rregullator projektvendimin “Për caktimin e rregullave për hedhjen e shortit për caktimin e renditjes të subjekteve zgjedhore në fletën e votimit” duke u bazuar në parimin e transparencës dhe të barazisë. Në përfundim të afatit për regjistrimin e subjekteve zgjedhore, janë regjistruar gjithsej 1 koalicion zgjedhor dhe 9 parti politike që garojnë më vete. Rënditja e subjekteve zgjedhore në fletët e votimit, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie do të bëhet me short. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore dhe koalicionet njoftohen për datën dhe orën e caktimit dhe për organizimin e shortit. Mosparaqitja e një prej përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore nuk pezullon procedurën e shortit. Në këtë rast Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve caktoi një nëpunës të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të analizojë procedurën e parashikuar në këtë vendim, për subjektin zgjedhor, përfaqësuesi i të cilit nuk është i pranishëm. Në rast se në përfundim të hedhjes së shortit, renditen njëra pas tjetrës subjektet zgjedhore, të cilat kanë emër

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.10.02.2022*


zyrtar, emblemën, siglën, ose shkronjat nistore të përfaqësuara që mund të shkaktojnë konfuzion apo lajthitje të votuesit, me kërkesë të një prej subjekteve, shorti mund të përsëritet deri në dy herë, deri në renditjen që nuk shkakton konfuzion për votuesit. Në zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie, organizohet shorti për renditjen në fletën e votimit e subjekteve zgjedhore, për çdo zonë zgjedhore, ose bashki. Renditja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit përcaktohet nëpërmjet dy proceseve, para shortit dhe shortit. Në parashort përcaktohet radha ndërmjet subjekteve zgjedhore për të tërhequr numrin që do të ketë subjekti në fletën e votimit. Në procedurën e shortit përcaktohet numri që do të ketë, do të mbahet subjekti zgjedhor në fletën e votimit. Kjo procedurë përsëritet për secilën zonë zgjedhore, sipas renditjes së dekretit nr.13438, datë 20.01.2022 të Presidentit të Republikës, për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjeshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton me vendim rezultatet e shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për çdo zonë zgjedhore, ose bashki. Për sa më sipër keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Merkaj! Çelim diskutimin në parim për projektvendimin. Kolegë, zoti Logu, zoti Kaziaj?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Nuk kemi ndonjë objeksion lidhur me projektvendimin në parim!

**Znj. I. Nano:** Në rregull! Në kuadër të diskutimit në parim të projektvendimit, më lejoni t'ju them dy gjëra. Ky projektvendim vjen në kuadër të një vendimmarrje disahapëshe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ne pak më herët si Komision Rregullator kemi miratuar specifikimet teknike të fletës së

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.10.02.2022*

votimit. Sot po shqyrtojmë rregullat për hedhjen e shortit, më tej do të hidhet shorti dhe rezultati i shortit do të miratohet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, dhe më tej akoma, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do të përcaktojë përmbajtjen e fletës së votimit. Pra, janë njëra pas tjetrës të gjitha këto vendimmarrje. Kështu që unë e konsideroj të rëndësishëm në këtë moment shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektvendimi. Nëse nuk ka diskutime të tjera në parim, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

***Kush është dakord, kolegë?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***


***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro, miratohet në parim projektvendimi!

Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit nen për nen. Sikundër kemi vendosur një praktikë për shkak të volumit të tekstit në projektvendime, nuk do ta lexojmë të gjithë tekstin. Do të fillojmë me nenin 1, dhe ku kemi komente, pyetje, propozime për shtesa, apo për ndryshime, po qoftë dhe për riformulime nga këndvështrimi gjuhësor, janë të ftuar kolegët dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore. Fillojmë me nenin 1. Objekti. Ka propozime për shtesa, ndryshime? Po, zonja Vukaj!

***Znj. H. Vukaj:*** Faleminderit! Në kuadër dhe në meritë të harmonizimit të parimeve të Kodit të Procedurës Administrative, unë do t'i sugjeroja administratës që përpara se të citonte parimin e transparencës dhe barazisë, këto parime duhet të ndiqen nga parimi i objektivitetit, ndaj po bëj një sugjerim për ta shtuar dhe jo një propozim, sepse jam e sigurt që kjo është një qartësi për juristët e drejtorisë përkatëse. Pra, të vendoset parimi i objektivitetit, transparencës dhe barazisë, sepse i jep konsolidim frazës, por po ashtu edhe nenit. Dhe diçka tjetër, meqenëse ne arritëm në unifikim të perceptimit, por njëkohësisht edhe të shkrimit, të togfjalëshave që kanë të bëjnë me këto

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



zgjedhje. Dhe thamë që për këto zgjedhje, është më e volitshme, më e kuptueshme dhe më e pranueshme, që të shkruhen kudo ku shkruhen fjalët “për zgjedhjet e pjesshme”, jo më vendore, por “për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie”. Do të preferoja që ky rregullim të vinte nga ju, në momentin e nënshkrimit të këtij akti. Kudo ku ndodhet kjo frazë. Besoj se kolegët janë dakord sepse e kemi miratuar disa herë këtë rregullim.

**Znj. I. Nano:** Në fakt, kjo ndërhyrje e zonjës Vukaj është miratuar dhe në mbledhjen e kaluar. Kur flasim për zgjedhje të pjesshme, s’ka nevojë të themi vendore, sepse nisur nga përkufizimet e Kodit Zgjedhor, zgjedhjet e pjesshme janë zgjedhjet që kryhen në një nga më shumë njësi të qeverisjes vendore, për kryetar apo për...

**Z. Y. Merkaç:** Në fakt ne i kemi qëndruar strikt titullit të dekretit të Presidentit, prandaj.

**Znj. I. Nano:** Gjithsesi standardi që ne kemi vendosur ka qenë ai në raport me Kodin Zgjedhor. Pra, kur themi zgjedhje të pjesshme, i kemi për kryetar bashkie, kemi dhe datën, padyshim që kjo lidhet me dekretin e Presidentit. Kolegë, për këtë ndërhyrjen tjetër të zonjës Vukaj, për të shtuar parimin e objektivitetit besoj që nuk kemi asnjë kundërshti. Kështu që, i lutem administratës gjatë zbardhjes, pra, kalojmë në votimin e nenit 1. Objekti.

**Kush është dakord, kolegë?**


**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S’ka

Miratohet, me sugjerimin e zonjës Vukaj!

Kalojmë në nenin 2. Renditja e subjekteve zgjedhore, në fletën e votimit, në zgjedhjet e pjesshme vendore, e njëjta situatë, për kryetar bashkie. Lidhur me

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



këtë nen, unë gjithashtu si zonja Vukaj, kam një diskutim, se s'do ta quaja propozim konkret. Thjesht nga këndvështrimi gjuhësor do doja një riformulim në pjesën e fundit të fjalisë. Pra, “shorti mund të përsëritet deri dy herë, deri në renditjen që nuk shkakton konfuzion”. Do thoja për të qenë të qartë dhe për të mos përsëritur dy fjalë të njëjta brenda të njëjtës fjali, “shorti mund të përsëritet, jo më shumë se dy herë të tjera, deri në renditjen që nuk shkakton konfuzion”. Pra, ideja është, hedhim shortin në varësi të asaj çka na rezulton nga shorti mund të kemi parti apo subjekte zgjedhore me sigla, shkronja nistore të përafërta, se të njëjta sigurisht që nuk i lejon Kodi Zgjedhor në momentin e regjistrimit, por që mund të jenë pranë njëra-tjetrës, atëherë të mund të hidhet shorti jo më shumë se dy herë të tjera. Nuk e di kolegë? Po zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Në rast se do ta riformulojmë “jo më shumë se dy herë të tjera” i bie përveç asaj here, i bie dhe dy herë të tjera. Pra, në total 3 herë. Po ndërkohë këtu thotë dy herë. Përsëritet deri dy herë.

**Znj. I. Nano:** Pra, përsëritja është deri në dy herë, pra jo ajo që ndodh, përsëritja.

**Z. M. Çakaj:** Dakord! Thjesht të mos e ngarkojmë si fjali.

**Znj. I. Nano:** Përfaqësuesit e subjekteve lidhur me nenin 2? Atëherë kalojmë në votimin e nenit 2. Renditja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



Neni 3. Veprimet paraprahe. Kemi ndonjë propozim për shtesë, ndryshim, apo qoftë edhe ndonjë riformulim nga këndvështrimi gjuhësor? Nuk ka! Kalojmë në votimin e nenit 3.

***Kush është dakord, kolegë, me nenin 3 sipas përmbajtjes së propozuar?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro, miratohet!


Kalojmë në nenin 4. Në fakt është neni më i rëndësishëm që përcakton gjithë procedurën që zhvillohet. Titullohet “Procedura e shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore” dhe përmban në vetvete dy procese që zhvillohen, parashortin dhe shortin. Parashorti përcakton radhën mes subjekteve zgjedhore për të tërhequr numrin që do të ketë subjekti në fletën e votimit, ndërsa shorti, procesi i dytë, përcakton numrin që do të mbajë subjekti zgjedhor në fletën e votimit. Kolegë, zonja Vukaj!

***Znj. H. Vukaj:*** Për të mos krijuar përsëritje në pikën 2, të nenit 4, në germën “a”, ku thuhet “parashorti zhvillohet për çdo zonë zgjedhore (bashki si më poshtë)” dhe kjo bie jo ndesh, por në përsëritje me frazën më lartë. Do të sugjeroja të arrinim në korrigjimin, siç do citoj “parashorti zhvillohet sipas kësaj procedure”

***Znj. I. Nano:*** Besoj togfjalëshi “për çdo zonë zgjedhore” qëndron, sepse ky është koncepti.

***Znj. H. Vukaj:*** “Parashorti dhe shorti zhvillohen sipas procedurës së mëposhtme, parashorti zhvillohet për çdo zonë zgjedhore sipas kësaj procedure”.

***Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA***



**Znj. I. Nano:** Nëse do të biem dakord me këtë riformulim të zonjës Vukaj, atëherë do duhet edhe në shkronjën “b”, është shorti. Kolegë me këtë ndërhyrje të zonjës Vukaj, për një riformulim, jeni dakord? Po në përmbajtje, kemi diçka? Pra propozimi i zonjës Vukaj është që të riformulohet “parashorti zhvillohet për çdo zonë zgjedhore, bashki sipas kësaj procedure”, e njëjta gjë dhe në shkronjën “b”. Atëherë jemi te neni 4. Përveç këtyre dy riformulimeve sipas vërejtjes së zonjës Vukaj, kemi diçka për nenin 4? Kolegë dhe përfaqësues? Zoti Logu!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zonja Nano! Në fakt po diskutonim dhe paraprakisht përpara mbledhjes. Mendojmë që do t’u shërbente edhe subjekteve zgjedhore, por edhe zgjedhësve për të pasur qartësinë, qoftë edhe gjatë fushatës zgjedhore, duke pasur parasysh edhe kohën e shkurtër që është në dispozicion për këtë proces, që shorti mos të hidhet për çdo bashki, ose për çdo zonë zgjedhore më vete, por të ketë vetëm një short, dhe atë numër që një parti, po them Partia Demokratike do ketë në Bashkinë Shkodër, ta ketë në të gjashta bashkitë. Kjo besoj që do i shërbente edhe vetë fushatës që bëjnë subjektet zgjedhore, por do u shërbente dhe votuesve për të qenë të qartë në një periudhë të shkurtër. Kjo do kërkonte në fakt që të riformulohej, ose të ndryshonte pjesërisht, pika 1 e nenit 4. Pra, “në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie organizohet shorti për renditjen në fletët e votimit të subjekteve zgjedhore”, vetëm njëherë. Parashorti zhvillohet, mund të jem dakord dhe me propozimin që bëri zonja Vukaj, që do ta evitonte pastaj që të përsërisim këtë “vetëm një herë”, duke bërë qoftë tek germa “a” e pikës 2, qoftë tek germa “b”. Ndërkohë që sigurisht që në lidhje kronologjike ose logjike do ishte që të ndryshohet më pas edhe neni 5, duke u hequr togfjalëshi “për çdo zonë zgjedhore bashki”. Gjithsesi në vlerësimin tuaj, por mendojmë që hedhja e shortit vetëm njëherë dhe dhënia e vetëm një numri, për subjekt zgjedhor, besoj




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 10.02.2022*

që do t'u lehtësonte punën jo vetëm subjekteve, por edhe do t'i ndihmonte zgjedhësit në zgjedhjen e tyre, në 6 mars.

**Znj. I. Nano:** Zoti Logu, faleminderit për propozimin! Unë do t'i drejtohem edhe administratës, por paraprakisht më lejoni të them mendimin tim lidhur me këtë çështje. Ditën e djeshme ka përfunduar depozitimi i dokumenteve të kandidimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nëse deri para këtij momenti ne kishim 9 parti politike dhe një koalicion zgjedhor të regjistruar, pra, kishim 10 subjekte, nga informacionet zyrtare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sot që po flasim dhe po shqyrtojmë këtë projektvendim, kemi 3 subjekte zgjedhore, të cilat kanë sjellë kandidatë për 4 bashki, dhe në 2 bashki të tjera kemi 4 subjekte zgjedhore që kanë sjellë kandidatë. Pra, minimalisht nuk kemi të njëtin numër dhe të njëjtat subjekte zgjedhore. E dyta. Jemi në kushtet që kanë ardhur kërkesat, pra janë depozituar dokumentet dhe nuk kemi një vendimmarrje për regjistrimin e kandidatëve, gjë që prapë lë një pikëpyetje në varësi të verifikimeve që është duke bërë në procesin që KQZ-ja është duke u zhvilluar. Nuk dimë në përfundim të këtij procesi, nëse do të kemi një numër të barabartë kandidatësh, dhe një numër të barabartë subjektësh në çdo bashki. Nuk e di administrata kur kanë propozuar këtë projektvendim dhe kanë propozuar gjithashtu që të hidhet shorti për secilën bashki, ka pasur parasysh ndonjë përvojë të mëhershme, në hedhjen e shortit për renditjen në fletën e votimit, po themi për zgjedhjet vendore? Zgjedhjet për njësitë e qeverisjes vendore?

**Z. Y. Merkaç:** Po, zonja kryetare është ashtu siç thatë dhe ju, që në zgjedhjet e 2015-ës kemi pasur raste që një zonë zgjedhore ka pasur më shumë subjekte dhe kandidatë se zona tjetër zgjedhore. Kështu që shorti duhet hedhur për çdo zonë zgjedhore.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Znj. I. Nano:** Pra, në 2015-ën është hedhur shorti për 61 për çdo..

**Z. Y. Merkaj:** Për çdo zonë zgjedhore, po!

**Znj. I. Nano:** Po, kolegë, zonja Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Në vijim të shqetësimit, ose propozimit le të themi, që ngriti zoti Logu, do të thosha se, në parim shkon fiks me logjikën e facilitetit operacional të subjektit zgjedhor. Pra, unë bie dakord në parim me zotin Logu, por do të thosha, sikundër ju pohuat, që kjo është tradita e përvijuar dhe këtë e kemi verifikuar pak më herët edhe në arkivën e KQZ-së, do thosha, ju si draftues apo drejtori juridike, a shikoni ndonjë normë e cila është shtesë, apo është amendim, apo është risi në Kodin Zgjedhor, përpos traditës, që ndoshta propozimi i zotit Logu, të kishte një mbështetje ligjore dhe të gjente vend.

**Znj. M. Koja:** Atëherë, referuar parashikimeve ligjore nuk ka një normim për mënyrën sesi hidhet shorti, në lidhje me shqetësimin e ngritur. Nga pikëpamja ligjore mendoj që jemi korrektë edhe duke vlerësuar krahas përvojës së konsoliduar të mëparshme për zgjedhjet vendore, por nisur dhe nga rrethanat konkrete të zgjedhjeve të vitit 2022, kur sikundër juve zonja Nano përmendët më herët, kemi dy bashki, Bashkinë Durrës dhe Bashkinë Dibër, ku janë regjistruar, kanë propozuar kandidatë, 4 subjekte zgjedhore dhe 3 për bashkitë e tjera. Pra, të paktën nuk mund të kemi një short për të gjitha bashkitë. Do të ishte e pamundur. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Znj. I. Nano:** Zoti Logu, mbas këtyre argumenteve, edhe të administratës, si mendoni lidhur me propozimin tuaj? A vlerësoni që ka mundësi praktike, se nuk është çështja tek mbështetja ligjore. Ai është një normë që ne e vendosim.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po! Siç u tha me të drejtë, domethënë neni 98, pika 5 është baza ligjore e këtij projektvendimi. Nuk është se na imponon një formë, ose një formë tjetër të caktuar. Sigurisht që forma duhet të jetë ajo që është më e thjeshta dhe më e lehta, besoj qoftë për administratën zgjedhore, për subjektet, për zgjedhësit. Unë vlerësoja që kjo, po themi, hedhja vetëm e një shorti, sigurisht që e kuptoj që në disa bashki ka më shumë, pra nuk jemi në rastin kur të gjitha subjektet kandidojnë në të gjitha bashkitë, dhe kjo pastaj do ta komplikonte formulën, në qoftë se për disa e bëjmë një formë, për disa e bëjmë në një formë tjetër. Kështu që duke pasur parasysh situatën faktike jam dakord që të vijohet në atë mënyrë që është propozuar nga administrata zgjedhore.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Logu! Kolegë kemi diçka tjetër për nenin 4, apo të kalojmë në votimin e tij? Atëherë kalojmë në votimin e nenit 4.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 5. Rezultati i shortit. Atë që diskutuam dhe më herët, që mbasi miratojmë ne këtë vendim, do të hidhet shorti. Komisioneri miraton me akt të vetin, me vendim rezultatin e shortit. Nëse s'ka diskutime, kalojmë në votimin e nenit 5.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 6. Hyrja në fuqi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Pasi e kemi votuar atë në parim dhe nen për nen.

***Kolegë, kush është dakord me projektvendimin?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro, sapo miratuam vendimin "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar, të datës 6 Mars 2022". Duke qenë që nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës për diskutim, më lejoni të mbyll mbledhjen. Faleminderit!

**Vendimi nr. 16**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

